

**V E N D I M**  
**Nr. 369, datë 23.7.2002**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE DHE NË VENDIMIN 726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.60, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 4, shtesa për vështirësi vendi e shërbimi, të lidhjes "Shtesat mbi pagën bazë për ushtarakët aktivë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes", të bëhet "deri në 35 për qind të pagës mujore".

b) Në pikën 2, paga e ushtarëve dhe studentëve ushtarakë të bëhet deri 1 165 (një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

c) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura 112 500 lekë
- Zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura 94 500 lekë
- Komandant i Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare 94 500 lekë
- Komandant i Doktrinave dhe Stërvitjes 80 000 lekë
- Komandant i Komandës Logjistike 80 000 lekë
- Drejtor drejtorie 73 000 lekë

Për këto funksione nuk zbatohet shtesa për natyrë të veçantë pune.

2. Në pikën 20 të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, masa e shtesës për natyrë të veçantë pune, që përfitojnë punonjësit civilë, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes të bëhet "deri në 35 për qind".

3. Efektet financiare prej 9 000 000 (nëntë milionë) lekësh në muaj, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2002.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**